



Drejtuar: Komisionit të Përhershëm Statutor

Z. Gazment Bardhi, Z. Edi Paloka, Z. Edmond Spaho, Znj. Albana Vokshi, Z. Belind Këlliçi, Znj. Jorida Tabaku, Z. Enkelejd Alibeaj, Z. Enno Bozdo, Znj. Grida Duma.

**Lënda:** Dërgohet për mendim draft Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë, në përputhje me nenin 73 të Statutit

---

Të nderuar anëtarë të Komisionit,

Bashkëlidhur do të gjeni për mendim dhe vlerësim draft Statutin e Partisë Demokratike, ku janë pasqyruar disa ndryshime, si më poshtë:

1. Janë përfshirë si vlera që mbrohen, promovohen dhe nxiten nga Partia Demokratike, meritokracia dhe shanset e barabrata në punësim dhe karrierë, duke nxitur një administratë publike të qendrueshme dhe profesionale; lufta ndaj korrupsionit dhe dhënia fund e fenomenit të pandëshkueshmërisë; shkëputja e lidhjeve midis politikës dhe krimit të organizuar, përmes dekriminalizimit të plotë të jetës politike dhe publike; si dhe nxitja e një sistemi drejtësie të pavarur dhe të paanshëm, që i shërben vetëm qytetarëve dhe interesit publik.
2. Është zgjeruar koncepti i demokracisë së brendshme në parti edhe për përzgjedhjen e kandidatëve për pushtetin lokal, duke ngushtuar kompetencën që kishte Kryetari i Partisë në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, detyrimi për konsultimin e anëtarësisë është përfshirë edhe për kandidatët për pushtetin vendor, të cilët pas konsultimit me anëtarësinë do të propozohen nga Kryetari i Partisë, caktohen nga Kryesia e PDSH-së dhe lista e plotë do të miratohet nga Këshilli Kombëtar. Në këtë mënyrë është përfshirë në vendimmarrje, si organ ratifikues i listës, edhe Këshilli Kombëtar.
3. Është rikonceptuar Kryesia e Seksionit, e cila do të përbëhet nga Kryetari, Sekretari dhe Nënkryetari i Seksionit. Kryetari i Seksionit zgjidhet nga anëtarët e seksionit sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Sekretari i Seksionit emërohet nga Kryetari i Degës. Nënkryetari i Seksionit emërohet nga Kryetari i Grupseksionit.
4. Është shtuar si strukturë vendore e partisë edhe Këshilli Koordinues i Qarkut, që drejtohet nga Drejtuesi Politik i Qarkut, që emërohet nga Kryetari i Partisë. Kjo do të jetë një strukturë e përhershme me përgjegjësi në organizimin elektorale dhe aksionet e veprimtaritë politike të PDSH në nivel qarku.

5. Është zgjeruar Kryesia e Degës së Partisë, ku do të përfshihen edhe anëtarët e Këshillit Kombëtar të PDSH që kanë vendbanimin në Degë apo janë caktuar të mbulojnë Degën; si dhe vetëm për Degët qendër qarku, 7 (shtatë) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Degës.

6. Është rikonceptuar mënyra e funksionimit të Këshillit Kombëtar, duke parashikuar që anëtarët e zgjedhur të Këshillit Kombëtar të organizohen në Departamente të Këshillit Kombëtar, që funksionojnë si strukturë këshillimore e Kryesisë dhe Kryetarit të PDSH-së, për çështje tematike. Departamentet e Këshillit Kombëtar janë përgjegjëse për përgatitjen e platformave, opinioneve, strategjive dhe programeve sektoriale, të cilat shërbejnë për formulimin e programit elektorale, programit të qeverisjes dhe veprimtarinë politike të PDSH-së.

7. Është zgjeruar Kryesia e Partisë, duke përfshirë si anëtarë të saj për shkak të funksionit edhe Kryetarin e Këshillit Kombëtar, Kryetarin e Bordit Financiar, Kryetarin e Komisionit Zgjedhor dhe Kryetarin e Komisionit të Apelit, Integritetit dhe Etikës. Gjithashtu është shtuar rregulli që jo më pak se 30 % e anëtarëve të zgjedhur të Kryesisë t'i përkasi gjinisë më pak të përfaqësuar.

8. Është rikonceptuar Sekretariati Ekzekutiv i Partisë, duke hequr numrin limit të sekretarëve funksional në përbërje të tij. Ky rregull është shtrirë edhe për Degët e Partisë.

9. Është bashkuar në një komision të vetëm Komisioni i Apelit dhe Komisioni i Integritetit dhe Etikës, duke i njohur kompetencën për vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin të rregullave për dekriminalizimin dhe integritetin vetëm Komisionit të Vlerësimit të Kandidatëve.

10. Është riformatuar Komisioni i Përhershëm i Statutit, i cili është përgjegjës edhe për interpretimin e dispozitave të Statutit. Komisioni i Përhershëm i Statutit do të përbëhet nga 7 anëtarë titullarë dhe dy anëtarë ndihmës, që caktohen nga Kryesia e Partisë.

11. Është harmonizuar dhe thjeshtuar përmbajtja e Statutit aktual, duke rregulluar pasaktësitë apo duke hequr parashikimet që përsëriten në tekstin e tij, por pa prekur thelbin e parashikimeve statutores.

Bashkëlidhur do të gjeni draftin e plotë të propozimit.

Duke ju uruar punë të mbarë,

KRYETARI  
LULZIM BASHA



*Lulzim Basha*



## STATUTI I PARTISE DEMOKRATIKE

### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Emri

Partia mban emrin Partia Demokratike e Shqipërisë dhe akronimin zyrtar PD.

#### Neni 2 Vlerat themelore politike

1. Partia Demokratike e Shqipërisë (në vijim: PDSH) është parti politike që bashkon në gjirin e saj shtetasit shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit, që besojnë, respektojnë dhe mbejnë:
  - a) lirinë dhe demokracinë;
  - b) ndërtimin e shtetit të së drejtës, demokratik e social, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dinjitetin dhe personalitetin njerëzor, si dhe prosperitetin e të gjithë kombit;
  - c) vlerat themelore të familjes tradicionale në shoqëri;
  - ç) shenjëtrinë e pronës private;
  - d) dekomunistizimin e shoqërisë shqiptare si një mision i vazhdueshëm;
  - dh) humanizimin e solidaritetin shoqëror dhe frymën e tolerancës e të bashkëjetesës fetare;
  - e) vlerat, parimet dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s;
  - e) aspiratën për integrimin e plotë evropian të Shqipërisë, nëpërmjet jetësimit të dëshirës së përbashkët, qasjes përfundimtare dhe thirrjes së brendshme të anëtarëve të saj "Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa".
  - f) drejtësinë, paqen, harmoninë dhe bashkëpunimin ndërmjet kombeve, si vlerat më të larta të njerëzimit.
2. PDSH-ja promovon në interes të Shqipërisë dhe shqiptarëve:
  - a) të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
  - b) zhvillimin e nismës së lirë e barazimit në shanse, tregun e lirë e konkurrencën si mjet të zhvillimit të shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit;
  - c) sigurinë e individit e të pronës;
  - ç) drejtësinë shoqërore e dialogun social;
  - d) paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror;
  - dh) pavaresinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kombëtare;
  - e) ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit;
  - ë) autonomitë të shtetit dhe vetëqeverisjen lokale;
  - f) meritokracinë dhe shanset e barabarta në punësim dhe karrierë, duke nxitur një administratë publike të qëndrueshme dhe profesionale;
  - g) luftën ndaj korrupsionit dhe dhënies fund të fenomenit të pandëshkueshmërisë;
  - gj) shkëputjen e lidhjeve midis politikës dhe krimi të organizuar, përmes dekriminalizimit të plotë të jetës politike dhe publike.
3. PDSH-ja është anëtare e Partisë Popullore Europiane dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga të njëjtat vlera e ideologji.

#### Neni 3 Qëllimet politike

1. PDSH-ja njih dhe promovon pjesëmarrjen e gjerë popullore në jetën politike, shoqërore dhe në institucione, si dhe kujdeset për formimin e një vullneti të gjerë e të qëndrueshëm popullor në dobi të mbrojtjes dhe zhvillimit të traditave më të larta shoqërore, politike dhe kulturore të shqiptarëve, në dobi të realizimit dhe zhvillimit të shpejtë të aspiratave euroatlantike të Shqipërisë, si dhe rrezatimin pozitiv të imazhit të vendit kudo në botë, për përjetësimin e kombit shqiptar, identitetin e kulturës së tij.
2. PDSH-ja udhëhiqet nga vlerat tradicionale të spektrit të djathtë: liria, demokracia, besimi te Zoti, familja tradicionale dhe shenjëtria e pronës private. Në thelb të filozofisë së saj qëndron liria dhe dinjiteti i individit, konkurrenca e ndershme dhe meritokracia.
3. PDSH-ja i realizon objektivat e veta politike nëpërmjet komanikimit e angazhimit politik, publik dhe përmes pjesëmarrjes në zgjedhje, në përputhje dhe respektim të plotë të kuadrit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Shqipërisë.
4. PDSH-ja synon:
  - a) të ndërtojë një demokraci të së drejtave njerëzore të njohura e të marra në mbrojtje nga dokumentet ndërkombëtare, të mbështetur në bashkësinë e njerëzve të lirë, të përgjegjshëm, që bashkëpunojnë, respektojnë e ndërmarrin përgjegjësi të përbashkëta;
  - b) të ndërtojë shtetin ligjor me raporte të balancuara e të ndara qartë të pushteteve, garant të jetës, lirisë dhe të drejtave të sanksionuara me ligj të qytetarëve;
  - c) të zhvillojë ekonominë e tregut nëpërmjet nxitjes së nismës së lirë ekonomike e shtimit të pronës private si forma mbisunduese në krijimin dhe pronësimin e pasurisë kombëtare, nëpërmjet privatizimit të ndërmarrjeve ekonomike publike, liberalizimit të tregut e licencimeve, zbatimit të politikave favorizuese fiskale e të kreditimit, etj.;
  - ç) të garantojë të drejtën e pronës private, paprekshmërinë e saj dhe të drejtën e pronarëve për ta zotëruar atë lirisht, trashëguar apo dëmshpërblyer me vlerë të plotë tregu;
  - d) të përfaqësojë interesat e grupeve shoqërore të të përndjekurve politike dhe pronarëve të ligjshëm të shpronësuar gjatë regjimit komunist, duke promovuar, ndërmarrë dhe zbatuar çdo normë ligjore, që garanton vendosjen e drejtësisë dhe rikthimin e dinjitetit të munguar, si dhe duke korrigjuar të gjitha pasojat financiare të padrejtësive të bëra ndaj tyre gjatë komunizmit;
  - dh) të zhdukë privilegjet dhe pabarazitë që nuk përrijnë as nga puna e pronë, as nga talenti e as nga shërbimet e kryera ndaj vendit;
  - e) të promovojë respektimin e barazisë gjinore në jetën e partisë dhe pjesëmarrjen e grave në organet e zgjedhura dhe ato ekzekutive;
  - ë) të integrojë Shqipërinë si anëtare dinjitoze në Bashkimin Europian.

- f) të garantojë sigurinë kombëtare dhe të kontribuojë si vend anëtar i NATO-s dhe në bashkëpunim me institucionet europiane, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të tjera organizima ndërkombëtare për të siguruar paqen, lirinë, demokracinë, garancinë ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit për të gjithë rajonet dhe me gjërë;
- g) të mbrojë interesat kombëtare dhe të drejtat njerëzore të shqiptarëve kudo që janë, duke respektuar aktet e marrëveshjet ndërkombëtare dhe duke kërkuar standardet e pranura botërisht për të gjithë, etj..
- gj) të nxisë një sistem drejtësie të pavarur dhe të paanshëm, që i shërben vetëm qytetarëve dhe interesit publik.
5. Qëllimet politike dhe vlerat themelore politike të PDSH-së detajohen dhe pasqyrohen në programin e saj, si dhe në dokumente të tjera që miratohen në përputhje me Statutin nga organet e saj qendrore, si dhe janë të detyrueshme për zbatim në çdo vendimarrje, veprimtari apo aksion politik të PDSH.

#### Neni 4

##### Organizimi i partisë

1. PDSH-ja është një organizim politik i qytetarëve të grupuar me vullnet të lirë në strukturat e saj, të organizuara në nivel kombëtar dhe lokal.
2. Organizimi në nivel lokal bëhet mbi bazën e një prej kriterëve të mëposhtem:
  - a) ndarjes territoriale administrative të vendit;
  - b) njësisve bazë elektorale;
  - c) mbi baza socio-profesionale; dhe/ose
  - ç) mbi baza përfaqësimi të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.
3. Struktura organizative e partisë në nivel lokal përcaktohet me vendim të Kryesisë së PDSH-së, mbi bazën e kriterëve specifike apo rrethanave të caktuara, sipas propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm të PDSH.

#### Neni 5

##### Selia Qendrore

PDSH-ja e ka selinë qendrore të saj në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

#### Neni 6

##### Simboli

Simboli i PDSH-së përbëhet nga germa "P" e "D" me ngjyrë blu, ku e para është vendosur brenda të dytës në mënyrë të stilizuar. Ky simbol përdoret nga organet përfaqësuese të PDSH-së ose me autorizim të tyre.

#### Neni 7

##### Flamuri

Flamuri i PDSH-së është me ngjyrë blu, në mes të të cilit ndodhet simboli i saj në ngjyrë të bardhë.

#### Neni 8

##### Vula

1. Vula e PDSH-së është e rumbullakët, e përbërë nga dy rrahë bashkëqendrorë në hapësirën midis të cilëve është shkruar me germa të mëdha "Partia Demokratike e Shqipërisë" dhe në mes ndodhet simboli i PDSH-së.
2. Vula përdoret vetëm në emër të Organeve Qendrore të PDSH-së dhe administratës ekzekutive të Selisë Qendrore. Degët e PDSH-së në rrethe kanë vulat e tyre që ruajnë modelin e mësipërm, duke shtuar emrin përkatës të degës.
3. Rregullat për ruajtjen dhe përdorimin e vulës përcaktohen me urdhër të Kryetarit të Partisë.

## KREU II

### RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË PARTISË

#### Seksioni I

##### PARIMET THEMELORE TË FUNKSIONIMIT

#### Neni 9

##### Bazat e funksionimit

Funksionimi i PDSH-së bazohet në:

1. demokracinë e brendshme, e shprehur përmes votës së anëtarëve të saj, drejtpërdrejtë dhe/ose përfaqësuesve të mandatuar prej tyre, në propozimin apo zgjedhjen e organeve drejtuese të partisë dhe kandidaturave elektorale, sipas rasteve dhe rregullave të përcaktuara në këtë Statut. Vota e përfaqësuar u njihet vetëm përfaqësuesve të mandatuar prej anëtarëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Statut.
2. lirinë e shfaqjes së mendimit, e cila është e garantuar në çdo mbledhje të strukturave të partisë apo veprim të PDSH-së. Çdo anëtar është i lirë të shprehë mendimin dhe propozimin e tij për përmirësimin e punës apo veprimeve politike të PDSH-së.
3. kolegjalitetin në marrjen e vendimeve, duke respektuar përfshirjen e të gjithë anëtarëve, personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, në çdo vendim apo veprim politik të PDSH-së. Organet dhe funksionaret e partisë gjatë veprimtarisë së tyre përfaqësojnë dhe i shërbejnë vullnetit të anëtarëve, si dhe tërheqin dhe parashtrajnë mendimin e anëtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë partiake, përfshirë edhe mendimet ndryshe.
4. transparencën në vendimarrje dhe në veprimtarinë politike të PDSH-së, duke informuar anëtarët dhe simpatizantët mbi to. Mbledhjet dhe veprimtaria e organeve të partisë është e hapur për anëtarët e saj, me përjashtim të rasteve, kur shumica e anëtarëve të organit vendos ndryshe, me qëllim ruajtjen e karakterit konfidencial të mbledhjes apo veprimtarisë. Në çdo rast, vendimet që merren dhe dokumentet që pasqyrojnë veprimtarinë e organit përkatës, u bëhen të njohura anëtarëve të partisë nëpërmjet strukturave organizative të partisë, dhe/ose mjeteve të informimit publik.
5. shanset e barabarta në pjesëmarrje dhe përfaqësimin midis grave dhe burrave, duke synuar dhe oxitar që në çdo organ apo nivel, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave të jetë jo më pak se 30 për qind të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në atë organ apo nivel përfaqësimi.
6. solidaritetin dhe mbështetjen midis anëtarëve dhe strukturave drejtuese të partisë. Anëtarët e PDSH-së, të organizatave të saj partnere, si dhe simpatizantët e tyre, veprojnë në bashkëpunim dhe ndihmojnë njëri-tjetrit. Organet qendrore të PDSH-së, si dhe strukturat e saj ekzekutive,

kujdesen për marrjen në mbrojtje të anëtarëve, simpatizantëve dhe mbështetësve të tyre nga çdo pasojë e mundshme që rrjedh prej pjesëmarrjes në veprimtarinë politike të kryer në përputhje me këtë Statut, apo hindjeve të tyre politike.

#### Neni 10

##### E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur

1. Çdo anëtar që përmbush kushtet e parashikuara në këtë Statut, apo kriteret e posaçme për një funksion partiak të caktuar, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Vota e çdo anëtari është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
2. Organizimi i brendshëm i partisë bazohet në një sistem zgjedhesh të lira, të barabarta, dhe periodike. Mandati i organeve në PDSH dhe organizatave të saj partnere, është katër vjet.
3. Sistemi zgjedhor brenda partisë, garanton parimin e konkurrimit të lirë dhe shanseve të barabarta midis kandidatëve, sipas kriterëve të shpallura dhe të njohura paraprakisht. Kandidatëve për çdo organ të partisë u garantohej e drejta e barabartë në procesin zgjedhor dhe kontrollin mbi mënyrën e realizimit të tij. Realizimi i çdo procesi zgjedhor brenda partisë udhëhiqet nga parimet demokratike dhe transparencë.
4. Karriera e çdo anëtari dhe/ose simpatizanti të PDSH-së, në funksionet brenda organeve të partisë apo funksionet politike përfaqësuese dhe/ose shtetërore, bazuar në meritokracinë dhe kontributin politik, elektoral dhe profesional të tij, është e garantuar. Zgjedhja apo caktimi në këto funksione bëhet bazuar në kohëzgjatjen e anëtarësisë në parti apo shfaqjes si simpatizant i saj; kontributit në fushata elektorale; kontributit profesional e politik në parti, si dhe në promovimin e vlerave themelore që udhëheqin PDSH-në; aktivizimit në jetën politike e publike të vendit; mbrojtjes në vazhdimësi të interesave, vlerave dhe programit të PDSH-së; si dhe reputacionit në radhët e anëtarësisë dhe/ose shoqërisë në tërësi.
5. Si rregull, kur kjo është e zbatueshme sipas Statutit, në çdo organ të partisë, numri i anëtarëve të zgjedhur duhet të jetë më i madh se numri i atyre që hyjnë drejtpërdrejt si anëtarë të organit për shkak të funksionit të tyre.
6. Rregullat e hollësishme për të garantuar të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, kriteret e posaçme për çdo funksion politik brenda partisë apo për përfaqësimin politik në organet qendrore apo lokale, si dhe rregullat që garantojnë një proces zgjedhor demokratik dhe transparent, përcaktohen në aktet nënstatutore.

#### Neni 11

##### Llogaridhënia dhe vlerësimi i performancës

1. Organet e partisë dhe funksionarët politikë të PDSH-së japin llogari në mënyrë periodike për punën e tyre përpara organeve të tjera drejtuese të partisë, sipas hierarkisë, si dhe përpara anëtarëve të PDSH-së, sa herë kërkohet nga më shumë se 1/4 e tyre, sipas organizimit dhe nivelit të përfaqësimit.
2. Organet e partisë dhe funksionarët politikë të PDSH-së detyrohen të marrin dhe të parashitrojnë mendimin e zgjedhësve të tyre, përfshirë dhe mendimin ndryshe, si dhe raportojnë përgjigjen përpara tyre për vendimet e marra dhe veprimtarinë e tyre.
3. Anëtarët e PDSH-së, organet e partisë dhe funksionarët politikë të PDSH-së i nënshtrohen procesit periodik të vlerësimit të performancës dhe kontributit, nëpërmjet analizës dhe diskutimit të hapur me anëtarët, apo sondazheve të organizuara nga PDSH-ja, sipas organizimit dhe nivelit të pjesëmarrjes apo përfaqësimit. Vlerësimi periodik i performancës dhe kontributit mbahet në konsideratë gjatë ecurisë në karrierë të tyre brenda organeve të partisë apo funksioneve përfaqësuese politike.
4. Rregullat e hollësishme për të garantuar llogaridhënien dhe vlerësimin e performancës përcaktohen në aktet nënstatutore.

#### Neni 12

##### Zgjedhja e funksionarëve politikë, në nivel qendror apo lokal

1. Demokracia e brendshme dhe kolegjaliteti zbatohet edhe në përcaktimin e kandidatëve elektorale të partisë. Anëtarët e partisë kanë të drejtën e identifikimit dhe propozimit të kandidatëve të mundshme elektorale, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në aktet nënstatutore.
2. Kandidaturat për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë seleksionohen në bashkëpunim dhe konsultim aktiv me anëtarët e PDSH-së. Pas konsultimit me anëtarësinë, me propozim të Kryetarit të Partisë, Kryesia e PDSH-së vendos listën përfundimtare të kandidatëve elektorale për Kuvendin e Shqipërisë. Kjo listë i paraqitet për miratim Këshillit Kombëtar të PDSH-së.
3. Kandidaturat për zgjedhjet në pushtetin vendor seleksionohen në bashkëpunim dhe konsultim aktiv me anëtarët e PDSH-së. Pas konsultimit me anëtarësinë, kandidaturat për organet ekzekutive të pushtetit vendor propozohen nga Kryetari i Partisë, caktohen nga Kryesia e PDSH-së dhe lista e plotë miratohet nga Këshilli Kombëtar. Kryesia e Degëve vendosin për kandidatë dhe këshilltarë në njesitë vendore. Kryesia e PDSH-së duhet të informohet për çdo hap të procesit të miratimit të kandidatëve dhe ka të drejtën e ndërhyrjes sa herë që e vlerëson të domosdoshme. Përgjithësisht, për bashkitë qendër qarku, lista e këshilltarëve propozohet nga Kryesia e Degës, dhe miratohet nga Kryetari i Partisë.
4. Rregullat e detajuara për realizimin e procesit të propozimit, përzgjedhjes, konsultimit dhe caktimit të kandidatëve elektorale të partisë përcaktohen në aktet nënstatutore.

#### Neni 13

##### Disiplina e brendshme

1. Anëtarët kujdesen për ruajtjen e etikës në komunikim dhe respekt të ndërsjellë ndaj njëri-tjetrit, organeve të partisë dhe funksionarëve politikë.
2. Anëtarët dhe organet e partisë veprojnë në përputhje me Statutin dhe Programin e PDSH-së. Çdo vlerësim apo nismë personale e anëtarit të partisë, e shprehur nën këtë cilësi, duhet të jetë në përputhje me Statutin dhe Programin e PDSH-së. Anëtarët e PDSH-së veçanërisht shmangin çdo mënyrë, veprim apo neglizhencë që dëmton interesat elektorale apo politike të PDSH-së.
3. Rregullat e hollësishme për të garantuar disiplinën e brendshme dhe masat disiplinore në rast të cenimit të saj, përcaktohen në aktet nënstatutore.

#### Neni 14

##### Format e veprimit dhe bashkëpunimit

1. Partia Demokratike e Shqipërisë për realizimin e synimeve të saj vepron nëpërmjet:
  - a) veprimtarisë së anëtarëve të saj, organeve lokale e qendrore, strukturave ekzekutive;
  - b) zbatimit të platformës dhe programeve të saj kur qeveris e vetme ose në koalicion si dhe nëpërmjet qeverisjes lokale që përfaqëson PDSH-ja;
  - c) grupit parlamentar;
  - d) organizatave partnere dhe organizatave e shoqatave të tjera të afërta me PDSH-në;
  - e) bashkëpunimit me partnerë të huaj, organizata e institucione ndërkombëtare.
2. PDSH-ja, për realizimin e objektivave dhe funksioneve të saj përdor mediat publike dhe private, dhe çdo formë tjetër komunikimi publik, manifestime e protesta, takime të hapura e tubime, konferenca e seminare, si dhe çdo formë tjetër të ligjshme.

**Neni 15**  
**Veprimtari publike**

1. PDSH në përputhje me legjislacionin në fuqi organizon, për qëllime të realizimit të objektivave të veta të ligjshme dhe promovimit të vlerave të saj themelore, edhe veprimtari ekonomike, studimore, klube, institute, apo forma të tjera të organizimit shoqëror.
2. Veprimtari e PDSH-së janë si rregull publike, me përjashtim të rasteve, kur vlerësohet se mund të dëmtohet interesi politik i saj. Ato zhvillohen si brenda territorit të vendit, ashtu edhe jashtë tij, kur një gjë e tillë është e lejueshme në vendet përkatëse.

**Seksioni 2**  
**PROCEDURA E MBLEDHJES E ORGANEVE TË PARTISË**

**Neni 16**  
**Garantimi i shprehjes së lirë të çdo anëtarit në mbledhjen**

Çdo anëtar ka të drejtë të shprehë lirshëm mendimin e tij në strukturat dhe organet e PDSH-së, të cilat kanë për detyrë të garantojnë dhe respektojnë shprehjen e mendimit ndryshe. Për këtë, kur diskutohen çështje për të cilat ka mendime "pro" dhe "kundër", të garantohet shprehja e të paktën një mendimi pro dhe kundër propozimit.

**Neni 17**  
**Aftësia vendimmarrëse**

1. Organet e Partisë kanë aftësi vendimmarrëse kur janë thirrur sipas rregullave të parashikuara në këtë Statut, si dhe kur në mbledhje kanë marrë pjesë mbi 50% e anëtarëve me të drejtë vote, me përjashtim të rasteve, kur në Statut parashikohet një shumicë më e madhe se kjo për marrjen e vendimeve.
2. Në rast se në mbledhje nuk janë të pranishëm anëtarët e nevojshëm për të siguruar shumicën e kërkuar për vendimmarrje, drejtuesi i mbledhjes nuk duhet të fillojë mbledhjen dhe njofton shtyrjen e mbledhjes për një datë dhe orë tjetër. Në këtë rast, ai mund të mos marrë parasysh afatet e përcaktuara në Statut. Mbledhja tjetër është në çdo rast me aftësi vendimmarrëse dhe kjo u njoftohet anëtarëve sëbashku me datën dhe orën e mbledhjes tjetër. Nëse mungesa e numrit të nevojshëm të anëtarëve për marrjen e vendimit gjatë mbledhjes vërtetohet në çastin e votimit, atëherë votimi shtyhet për në një mbledhje tjetër.
3. Në përcaktimin e numrit të nevojshëm për të siguruar aftësinë vendimmarrëse illogariten edhe abstenimet dhe/ose votat e pavlefshme.

**Neni 18**  
**Shumica e kërkuar për vendimmarrje**

1. Vendimet miratohen me shumicën e votave të vlefshme të pjesëmarrësve në votim, me përjashtim të rasteve, të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni. Kur votat janë të barabarta propozimi i votuar konsiderohet i refuzuar.
2. Për ndryshime statutore nevojitet shumica e të gjithë anëtarëve me të drejtë vote.
3. Për miratimin e vendimit për shpërndarjen apo bashkimin e PDSH-së me një parti tjetër, duhet një shumicë prej 3/4 e votave.

**Neni 19**  
**Llojet e votimit**

1. Votimi bëhet i hapur duke ngritur dorën ose mandatin.
2. Votimi bëhet i fshehtë vetëm në rastet e përcaktuara nga Statuti, si edhe kur propozimi për votim të fshehtë mbështetet nga 1/6 e anëtarëve me të drejtë vote. Format e votimit të fshehtë përcaktohen në aktet nënstatutore.

**Neni 20**  
**Afatet e zgjedhjeve**

Të gjitha organet e Partisë duhet t'u nënshtrohen zgjedhjeve periodike të paktën çdo katër vjet.

**Neni 21**  
**Dokumentimi i vendimeve**

1. Vendimet e Kuvendit Kombëtar, të Këshillit Kombëtar, të Kryesisë së PDSH-së, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e Kryetarit të Partisë apo Sekretarit të Përgjithshëm, dokumentohen, protokollohen dhe arkivohen sipas rregullave të përcaktuara nga Sekretari i Përgjithshëm.
2. Për dokumentimin dhe njoftimin e vendimeve të organeve vendore të Partisë, është përgjegjës Sekretari i Degës. Vendimet e organeve vendore të Partisë dokumentohen, protokollohen dhe arkivohen sipas rregullave të përcaktuara nga Sekretari i Përgjithshëm.

**KREU III**  
**ANËTARËSIA**

**Neni 22**  
**Kushtet e anëtarësisë**

1. Anëtar i PDSH-së mund të jetë, çdo shtetas shqiptar që:
  - a) është mbi 15 vjeç;
  - b) pranon kushtet e anëtarësisë dhe përkrah e mbrohet vlerat themelore të PDSH-së;
  - c) nuk është anëtar i partive politike, apo i organizatave që nuk janë në partneritet të deklaruar e pranuar nga PDSH-ja.
2. Kërkesa për anëtarësim duhet të paraqitet me shkrim duke plotësuar formularin përkatës:
  - a) pranë Seksionit të Partisë ku kërkuesi ka banimin;
  - b) pranë Degës së Partisë ku kërkuesi ka banimin;
  - c) pranë selisë qendrore të PDSH-së, e cila ia përcjell Degës ku kërkuesi ka banimin.

3. Pranimi në seksionin apo degën e PDSH-së bëhet vetëm për anëtarët që banojnë në territorin përkatës, nëpërmjet regjistrimit të anëtarit në sistemin elektronik të antarësisë nga Dega e PDSH-së dhe pajisjes së tij me dokumentin e antarësisë.

4. Në rast refuzimi të kërkesës, personi mund të ankohet në organin epror më të afërt të organit që ka hedhur poshtë kërkesën për regjistrim, vendimi i të cilit mund të ankohet në Komisionin e Apelit, Etikës dhe Integritetit.

#### Neni 23

##### Regjistri i antarësisë

1. Evidentimi i antarëve të Partisë Demokratike bëhet në Regjistrin Bazë të Antarësisë në format elektronik dhe shkresor, i cili përmban të dhënat e përditësuara për të gjithë anëtarët e regjistruar në Partinë Demokratike. Regjistri administrohet dhe përditësohet nga Sekretari i Degës.
2. Rregullat e hollësishtme për formatin e regjistrit, administrimin, përditësimin dhe aksesimin e tij, përcaktohen me udhëzim të Sekretarit të Përgjithshëm.

#### Neni 24

##### Të drejtat dhe detyrat e anëtarit

1. Anëtari i PDSH-së ka të drejtë:

- a) të marrë pjesë dhe të shprehë lirisht mendimin e tij në mbledhjet e organeve të Partisë, si dhe në çdo veprimtari të PDSH-së;
- b) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e Partisë;
- c) të propozojë për të gjitha organet legjislativë e ekzekutive që përfaqësojnë PDSH sipas kushteve që parashikohen në këtë Statut,
- ç) t'u drejtohet për çështje vetjake e të Partisë të gjitha organeve drejtuese të saj.

2. Anëtari i PDSH-së ka për detyrë:

- a) të marrë pjesë rregullisht në organin ku bën pjesë, të jetë aktiv në veprimtarinë politike e elektorale të PDSH-së, si dhe të ndjekë jetën e brendshme organizative të saj;
- b) t'i paguajë Partisë kuotën vjetore të antarësisë. Masa e kuotës vjetore dhe rregullat për shpërndarjen e saj ndërmjet selisë qendrore dhe strukturave lokale përcaktohen me vendim nga Kryesia e PDSH-së;
- c) të paguajë kuotën e antarësisë brenda 60 ditëve nga data e thirrjes për pagimin e saj.
- ç) të respektojë disiplinën e Partisë të përcaktuar në këtë Statut, aktet nënstatutore dhe në aktet politike të shpallura nga PDSH.

3. Anëtarët e Partisë nuk mund të jenë njëkohësisht në më shumë se dy kryesi të organeve të Partisë pavarësisht nga niveli i tyre, me përjashtim të rasteve të pjesëmarrjes për shkak të funksionit që mban. Përkatesia në kryesitë e organizatave partnere nuk llogaritet.

#### Neni 25

##### Anëtarët me të drejtë vote

1. Anëtarë të PDSH-së, me të drejtë vote, janë të gjithë ata që përmbushin në mënyrë të njëkohshme kushtet e mëposhtme:

- a) kanë bërë antarësimin e tyre individual dhe janë pranuar e regjistruar si anëtar jo më vonë se 6 muaj përpara datës së zgjedhjeve të radhës;
- b) kanë paguar kuotën vjetore të antarësisë në masën e caktuar me vendim të Kryesisë së PDSH-së;
- c) ndaj tyre nuk është marrë masa disiplinore e përjashtimit apo pezullimit nga partia apo nuk kanë dhënë dorëheqjen;
- ç) marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve ku bëjnë pjesë apo në veprimtaritë politike ku kërkohet.

2. Mospagimi për 2 vjet rresht i kuotës së antarësisë, si dhe mospjesëmarrja për gjashtë muaj në mbledhje të njëpasnjëshme të organeve ku bën pjesë apo në veprimtaritë politike, pa shkaqe të përligjura, sjell humbjen e të drejtës së votës si anëtar i PDSH-së, me vendim të Kryesisë së Degës. Personi që ka humbur të drejtën e votës mund të ankohet në Komisionin e Apelit, Etikës dhe Integritetit.

#### Neni 26

##### Përfundimi i antarësisë

1. Antarësia përfundon kur anëtari vdes, largohet me kërkesën e tij ose përjashtohet.
2. Çdo anëtar mund të largohet nga Partia me vullnetin e tij, duke njoftuar seksionin ku bën pjesë ose organin ku është i zgjedhur.

#### Neni 27

##### Masat disiplinore

1. Thyerja e disiplinës së brendshme të Partisë, ndërmarrja e veprimeve, në çdo formë apo mënyrë, që dëmtojnë interesat elektorale apo politike të PDSH-së, dhe mospjesëmarrja në detyrimeve të antarësisë sjell sanksione dhe kufizime të të drejtave të anëtarit të PDSH-së.
2. Masat disiplinore që mund të merren ndaj antarëve janë: paralajmërimi, pezullimi dhe përjashtimi. Këto masa merren sipas rasisit nga Kryesia e Degës ose Kryesia e PDSH-së, dhe konfirmohen dhe/ose mund të apelojnë përpara Komisionit të Apelit, Etikës dhe Integritetit. Ato mund të bëhen publike.
3. Në tre muajt që paraprijnë çdo fushatë zgjedhore dhe një muaj pas saj, Kryesia e Partisë mund të deklarojë kundrejt një anëtarit, kushdo qoftë funksioni i tij, njërin prej sanksioneve që parashikon Statuti, nëse ai pengon zbatimin e vendimeve që kanë të bëjnë me kandidaturat në zgjedhje. Ky vendim është i ankimeshem dhe shqyrtohet nga Komisioni i Apelit, Etikës dhe Integritetit, brenda 5 ditëve nga paraqitja e ankimit.
4. Kërkesat për ripranim shqyrtohen nga kryesitë e Degëve, nëse vendimet janë marrë prej tyre, ose nga kryesia e partisë për të gjitha rastet e tjera.
5. Në raste urgjente, dhe veçanërisht në fushata elektorale, kryetari i Partisë mund të ushtrojë pushtetin e sanksioneve statutore. Sanksioni i ndërmarrë i paraqitet për miratim kryesisë së partisë në afatin më të shkurtër të mundshëm.
6. Rastet që përbëjnë shkelje disiplinore, si dhe rregullat e procedurat e dënies së sanksioneve përkatëse disiplinore për anëtarët përcaktohen në aktet nënstatutore.

#### Neni 28

##### Simpatizantët

1. PDSH-ja quan simpatizant të saj çdo qytetar që mbështet politikën apo veprimtarinë e saj dhe voton për të. Ajo nxit pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë publike dhe politike të saj.
2. Për evidentimin e simpatizantëve të PDSH-së krijohet Regjistri Bazë i Simpatizantëve në format elektronik, i cili përmban të dhënat e përditësuara në mënyrë periodike për të gjithë simpatizantët e PDSH-së. Të dhënat hartohen nga Kryetari i Seksionit, nën përgjegjësinë e Kryetarit të Grupseksionit, dhe i nënshtrohen përditësimit të paktën çdo 2 vjet.

3. Rregullat e hollësishme për formatin e regjistrit, administrimin, përditësimin dhe aksesimin e tij, përcaktohen me udhëzime të Sekretarit të Përgjithshëm.

## KREU IV ORGANIZIMI VENDOR I PARTISË

### Seksioni 1

#### Struktura e organizimit vendor të Partisë

#### Neni 29

##### Organizimi Vendor i PDSH-së

Njësitë organizative të PDSH-së në nivel vendor janë:

- a) Seksionet,
- b) Grupseksionet,
- c) Degët e Partisë Demokratike,
- ç) Këshilli Koordinues i Qarkut.

#### Neni 30

##### Seksioni

1. Seksioni është njësi bazë organizative e Partisë. Si rregull, ai organizohet mbi bazë territoriale, ku për çdo Qendër Votimi (QV), ngrihet një seksion ose, me miratim të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi bazën e kriterëve specifike apo rrethanave të caktuara. Në raste të veçanta, me vendim të Kryesisë së PDSH-së, seksioni organizohet edhe në nivel dege ose kombëtar mbi bazë specialitetesh, gjendjeje shoqërore e profesionale, studentore, shkollore, moshore. Çdo seksion duhet të ketë minimalisht 5 anëtarë me të drejtë vote.

2. Kryesia e Degës, përgjigjet për koherencën e organizimit të seksioneve në territorin përkatës të partisë dhe informon Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë. Krijimi, shkrija, bashkimi ose ndarja e seksioneve vendoset nga Kryesia e Degës përkatëse dhe miratohet me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Mbledhja e seksionit thirret nga kryetari, nga 1/4 e anëtarëve, apo nga Kryetari i Grupseksionit ku bën pjesë seksioni. Mbledhja thirret të paktën një herë në çdo dy muaj. Mbledhja e Seksionit dokumentohet rregullisht dhe raportohet pranë Sekretarit të Degës, i cili është përgjegjës për respektimin e periodicitetit të mbledhjeve të Seksioneve.

4. Seksioni drejtohet dhe përfaqësohet nga Kryetari, i cili zgjidhet çdo katër vjet, me votim të fshehtë, nga mbledhja e të gjithë anëtarëve të seksionit, sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Pranë çdo seksioni vepron Kryesia e Seksionit që përbëhet përveç Kryetarit, edhe nga Sekretari dhe Nënkryetari i Seksionit. Nënkryetari i Seksionit emërohet nga Kryetari i Grupseksionit. Sekretari i Seksionit emërohet nga Kryetari i Degës.

5. Seksioni, dhe sipas rastit Kryesia e Seksionit, është përgjegjëse për:

- a) organizimin e veprimtarisë politike në territorin e tij në përputhje me orientimet dhe qëndrimet e shpallura të PDSH-së;
  - b) identifikimin dhe mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me votuesit në territorin përkatës dhe për organizimin e punës për operacionet elektorale gjatë zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore;
  - c) identifikimin dhe angazhimin në veprimtari politike të simpatizantëve të PDSH-së me banim në territorin përkatës;
  - ç) pranimin e anëtarëve të rinj të PDSH-së;
  - d) propozimin e kandidaturave për drejtues dhe përfaqësues lokalë dhe qëndror të Partisë;
  - dh) t'i sugjeruar dhe propozuar Degës/Grupseksionit trajtimin e çdo problemi që gjykon se është në interes të Partisë apo qytetarëve në territorin që mbulon.
6. Kryetari i Grupseksionit, me miratimin paraprak të Kryesisë së Degës, mund të thërrasë zgjedhje të parakohshme në Seksion, në rastet kur performanca zgjedhore është dukshëm e ulët, kur veprimtaria e seksionit është më e ulët se objektivat e caktuara nga Kryesia e Degës, apo kur kërkohet në mënyrë të argumentuar për shkak të neglizhencës së rëndë të organeve drejtuese të Seksionit.

#### Neni 31

##### Grupseksioni

1. Grupseksioni krijohet në bazë lagjeje, grup lagjesh apo në bazë fshatrash, ose në raste të veçanta dhe me miratim të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi bazën e kriterëve specifike apo rrethanave të caktuara. Ai përbëhet nga seksionet e atyndodhura dhe secili grupseksion duhet të mbulojë një numër të përafërt zgjedhësish, sipas rregullave dhe numrit minimal e maksimal të zgjedhësive të përcaktuara me vendim të Kryesisë së PDSH-së. Kryesia e Degës vendos për ndarjen e degës në grupseksione dhe përcakton hartën dhe shtrirjen territoriale të çdo grupseksioni, të cilat miratohen me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm. Kryesia e Degës mund të vendosë edhe për ngritjen e grupseksioneve në emigracion apo mbi baza profesionale.

2. Grupseksioni drejtohet nga Kryetari, i cili zgjidhet çdo katër vjet, me votim të fshehtë, nga mbledhja e të gjithë anëtarëve të seksioneve në përbërje të atij Grupseksioni, sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Numri i kandidaturave që i nënshtrohen votimit duhet të jetë të paktën dy. Të drejtën për të propozuar kandidatë e kanë 1/5 e anëtarëve të seksioneve që përfshihen në atë grupseksion, Kryesia e Degës, si dhe Kryetari i Degës.

3. Kryetari i Grupseksionit është përgjegjës për organizimin dhe mbarevajtjen e punës në territorin e Grupseksionit. Veprimtaria e Kryetarit të Grupseksionit kontrollohet në mënyrë periodike nga Kryetari i Degës, i cili çdo 6 muaj raporton të Sekretarit të Përgjithshëm i PDSH-së.

4. Pranë çdo Grupseksioni vepron Kryesia e Grupseksionit që përbëhet përveç Kryetarit, edhe nga:

- a) Sekretari i grupseksionit, i cili emërohet nga Kryesia e Degës me propozim të Kryetarit të Degës.
  - b) kryetarët dhe sekretarët e seksioneve përbërëse;
  - c) anëtar i Këshillit Kombëtar dhe deputeti me banim aty;
  - ç) anëtarët e Kryesisë së Degës dhe të zgjedhurit vendorë me banim aty.
5. Kryesia e Grupseksionit mbledhet të paktën një herë në muaj me kërkesë të kryetarit të tij, Kryesisë apo Kryetarit të Degës, Kryesisë së PDSH-së, ose me kërkesë të jo më pak se 1/4 të anëtarëve të tij. Kryesia e Grupseksionit organizon punën për ndërmarrjen e aksioneve politike dhe/ose elektorale në territorin që mbulon.

6. Grupseksioni, dhe sipas rastit Kryesia e Grupseksionit, është përgjegjëse për:

- a) organizimin e veprimtarisë politike në territorin e tij në përputhje me orientimet dhe qëndrimet e shpallura të PDSH-së;
- b) identifikimin dhe përditësimin e informacioneve mbi votuesit në territorin që mbulon duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ta;
- c) identifikimin dhe angazhimin në veprimtari politike të simpatizantëve të PDSH-së me banim në territorin përkatës;



- d) organizimin dhe drejtimin e punës për operacionet elektorale gjatë zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore, sipas udhëzimeve të Kryetarit dhe/ose të Kryesisë së Degës;
  - e) pranimin e anëtarëve të rinj të PDSH-së;
  - f) propozimin për kandidaturë për drejtues dhe përfaqësues lokalë dhe qëndror të Partisë;
  - g) t'i bërë sugjerime dhe propozime Degës për çdo problem që grykon se është në interes të Partisë apo qytetarëve në territorin që mbulon.
7. Kryetari i Degës, me miratimin paraprak të Kryesisë së Degës, mund të thërrasë zgjedhje të parakohshme në Grupseksion, në rastet kur performanca zgjedhore është dukshëm e ulët, kur veprimtaria e grupseksionit është më e ulët se objektivat e caktuara nga Kryesia e Degës, apo kur kërkohet në mënyrë të argumentuar për shkak të neglizhencës së rëndë të organeve drejtuese të Grupseksionit.

### Neni 32

#### Dega e PDSH-së

1. Dega e PDSH-së formohet apo shkrihet me vendim të Kryesisë së PDSH. Ajo funksionon përgjithësisht në bazë të njësive të qeverisjes lokale apo çdo ndarje tjetër administrative territoriale të përshtatshme dhe përbëhet nga grupseksionet dhe seksionet e atyndodhura.
2. Dega drejtohet në periudhën mes kuvendeve nga Kryetari dhe Kryesia e Degës.
3. Shtetasit shqiptarë mund të themelojnë jashtë Shqipërisë degë të PDSH-së. Krijimi i degeve jashtë vendit miratohet nga Kryesia e PDSH-së. Ato shpërndajnë aty parimet dhe programet e PDSH-së, duke respektuar ligjet dhe rregullat e vendit përkatës. Këto degë organizohen dhe funksionojnë sipas rregullave të këtij statuti.

### Neni 33

#### Këshilli Koordinues i Qarkut

1. Këshilli Koordinues i Qarkut është strukturë e përhershme me përgjegjësi në organizimin elektorale dhe aksionet e veprimtarisë politike të PDSH në nivel qarku. Ai drejtohet nga Drejtuesi Politik i Qarkut, që emërohet nga Kryetari i Partisë.
2. Këshilli Koordinues i Qarkut ka në përbërje:
  - a) Kryetarin dhe Sekretarin e Degëve të Partisë në atë qark;
  - b) Deputetët, dhe në periudhën e fushatës zgjedhore, kandidatët për deputet të konfirmuar zyrtarisht;
  - c) Koordinatorë përgjegjës për detyra specifike të përcaktuara në aktet nënstatutore, të cilët emërohen nga Kryetari i Partisë, me propozimin e Drejtuesit Politik të Qarkut.
3. Këshilli Koordinues i Qarkut mbledhet të paktën një herë në muaj dhe raporton tek Sekretari i Përgjithshëm çdo 3 muaj për detyrat e realizuara. Koordinimi i veprimtarive politike dhe organizative të Degëve të PDSH-së në nivel qarku, si dhe rregullat për drejtimin, organizimin dhe zhvillimin e fushatave elektorale për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore, përcaktohet rast pas rasti me udhëzim të Kryetarit të PDSH-së.

### Sekcioni 2

#### Organet vendore të Partisë

### Neni 34

#### Kuvendi i Degës së PDSH-së

1. Kuvendi i Degës është organi më i lartë vendimmarrës i saj, dhe ka në përbërje:
    - a) Kryesinë e Degës;
    - b) Sekretarët e grupseksioneve të Degës;
    - c) Kryetarët e të gjitha seksioneve të Degës;
    - ç) Anëtarët e Bordit të Këshilltarëve;
    - d) Anëtarët e Këshillit Kombëtar të PDSH-së, që përfaqësojnë Degën ose janë me banim në degën përkatëse;
    - dh) Deputetët e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë, që përfaqësojnë Degën ose janë me banim në degën përkatëse;
  - e) Kryetarët e Bashkive të Degës, Prefekti, Kryetari i Qarkut, si dhe këshilltarët vendorë, anëtarë të PDSH-së;
  - e) Përfaqësues të zgjedhur prej organizatave partnere, LDG dhe FRPD. Numri i përfaqësuesve për secilën organizatë partnere është deri në 5% e numrit të përgjithshëm të gjithë anëtarëve të përcaktuara në shkronjat e mësipërme të kësaj pike.
2. Kuvendin e Degës e thërret Kryesia e Degës me miratimin e Kryesisë së PDSH-së. Ai mund të thirret edhe kur e kërkon 1/4 e anëtarëve të degës së Partisë ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit të Degës. Në këtë rast, caktimi i datës dhe i rendit të ditës duhet të bëhet jo më vonë se një muaj nga marrja e kërkesës. Njoftimi i datës dhe i rendit të ditës në çdo rast duhet të bëhet 5 ditë përpara.
3. Kuvendi i Degës së PDSH-së, ushtron këto përgjegjësi dhe të drejta:
- a) zgjedh Kryetarin e Degës;
  - b) vendos për çështje të rëndësishme politike të Degës;
  - c) i adreson kërkesa organeve qendrore të PDSH-së për çështje që e grykon të arsyeshme;
  - ç) përmbush çdo detyrë tjetër të caktuar me vendim të Kryesisë së PDSH-së.
4. Përpara fillimit të mbledhjes, Kuvendi i Degës së PDSH-së, me propozim të Kryesisë miraton 2/3 e anëtarëve të Komisionit të Mandateve, Votimit dhe Numrimit. Të drejtën për të adresuar propozime dhe kërkesa për mocion për çështje të veçanta e kanë Kryesia e PDSH-së, Kryesia e degës, 1/5 për qind e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit me të drejtë vote. Kërkesat për propozim kandidaturash dhe mocionet e shkarkimit të organeve të degës duhet të jenë miratuar paraprakisht në Kryesinë e PDSH-së.

### Neni 35

#### Kryesia e Degës së Partisë

1. Kryesia e Degës është organi më i lartë për drejtimin e Degës së Partisë ndërmjet dy kuvendeve. Ajo vendos për të gjitha çështjet që nuk janë kompetencë ekskluzive e Kuvendit të degës apo e organeve qendrore të PDSH-së.
2. Kryesia e Degës përbëhet nga:
  - a) Kryetari dhe Nënkryetari i Degës;
  - b) Kryetarët e Grupseksioneve të Degës;
  - c) Sekretari i Degës si dhe Sekretarët Funktionale të Degës;
  - ç) Deputetët e PDSH-së të zgjedhur në territorin e Degës apo që janë caktuar të mbulojnë Degën me vendim të Kryesisë së PDSH-së;
  - d) Kryetari i Grupit të Këshilltarëve bashkiakë, si dhe Kryetari i Bashkisë dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak, kur i përketin PDSH-së;
  - dh) Kryetari i Bordit Financiar.

- e) Kryetarin vendor të LDG dhe FRPD;  
 e) anëtarët e Këshillit Kombëtar të PDSH që kanë vendbanimin në Degë apo janë caktuar të mbulojnë Degën;  
 f) veitëm në Degët qendër qarku, 7 (shtatë) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Degës.  
 3. Në mbledhjet e Kryesisë së Degës marrin pjesë pa të drejtë vote edhe anëtarët e Bordit të Këshilltarëve  
 4. Kryesia ushtron këto përgjegjësi dhe të drejta:  
 a) i propozon Kryesisë së PDSH-së të paktën dy kandidatë për funksionin e Sekretarit të Degës;  
 b) zgjedh sekretarët funksionale të Degës;  
 c) zgjedh Kryetarin e Bordit Financiar të Degës;  
 ç) zgjedh anëtarët e Bordit të Këshilltarëve, duke caktuar edhe fushat që do të mbulojnë secili prej tyre;  
 d) propozon strukturën organizative të Degës;  
 dh) drejton dhe organizon të gjithë veprimtarinë e Partisë në territorin ku vepron në përputhje me këtë Statut dhe aktet e nxjerra nga organet qendrore të Partisë, si dhe vendimet e detyrat e lëna nga Kuvendi i Degës;  
 e) ndërhyr në rastet e shkeljes së akteve që rregullojnë funksionimin e brendshëm të Degës nga seksionet, grupseksionet dhe përcakton rregullat e procedurat për normalizimin e tyre;  
 e) organizon dhe drejton zgjedhjet në strukturat lokale të Partisë si dhe fushatat elektorale;  
 f) formulon dhe paraqet para organeve eprorë kërkesat dhe propozimet në emër të Degës së Partisë;  
 g) siguron dhe është përgjegjëse për veprimtarinë koherente të strukturave në varësi të saj, me veprimtarinë e përgjithshme të partisë në çështjet e organizimit, veprimtarive politike publike, veçanërisht të fushatave elektorale.  
 5. Mbledhja e Kryesisë thirret nga Kryetari të paktën një herë në muaj. Të drejtën e thirrjes së mbledhjes së Kryesisë së Degës për probleme të veçanta e kanë edhe 1/4 e anëtarëve të Kryesisë. Në këtë rast, kryetari njofton datën e mbledhjes jo më vonë se pesë ditë nga marrja e kërkesës.

#### Neni 36

##### Kryetari i Degës së PDSH-së

1. Kryetari i Degës së PDSH-së zgjidhet nga Kuvendi i Degës me votim të fshehtë nga jo më pak se dy kandidatura. Kandidaturat për Kryetar Dege duhet të jenë anëtarë prej të paktën 3 vjetësh dhe të plotësojnë kriteret që përcakton Kryesia e PDSH-së. Kandidaturat propozohen nga seksionet, Kryesia e Degës dhe Kryetari i Partisë. Kandidaturat e dala për kryetar të Degës i nënshtrohen një diskutimi dhe vlerësimi nga Kryesia e PDSH-së, e cila miraton përfundimisht propozimet për kandidaturat.
2. Kryetari i Degës përfaqëson anëtarësinë e partisë në territorin përkatës. Ai thërret dhe drejton mbledhjet e Kryesisë, fikson rendin e ditës në bashkëpunim me sekretarin e degës. Ai organizon funksionimin normal të Kryesisë dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve dhe orientimeve të saj. Ai përgjigjet për mbarevajtjen e funksionimit të përditshëm të partisë dhe shprehjen e lirë të çdo anëtari të Kryesisë.
3. Kryetari i Degës ndihmohet në ushtrimin e veprimtarisë së tij nga Nënkryetarët e Degës, të cilët mbulojnë dhe janë përgjegjës drejtpërdrejt për veprimtarinë politike në një territor të caktuar elektorale, si dhe për detyra të tjera të caktuara nga Kryesia e Degës. Nënkryetarët e Degës zgjidhen nga Kryesia e Degës, me propozim të Kryetarit të Degës.

#### Neni 37

##### Sekretari i Degës

1. Sekretari i Degës ka për detyrë zbatimin e vendimeve të organeve qendrore të Partisë në Degën përkatëse dhe për dokumentimin e veprimtarisë së organeve të Degës. Ai mbikëqyr zgjedhjet në parti.
2. Sekretari i Degës emërohet nga Kryesia e PDSH-së dhe duhet të jetë të paktën tre vjet anëtar i PDSH-së.
3. Çdo vit dhe jo më vonë se fundi i tremujorit të parë pas mbylljes së vitit paraardhës, Sekretari i Degës i paraqet Kryesisë së Degës një raport të veprimtarisë së Degës, ku përfshihen veçanërisht anëtarësimet e reja në degë, përmbushja e detyrave të lëna nga organet qendrore të Partisë, financimi i Partisë dhe funksionimi organizativ i strukturave në Degë. Raporti pas diskutimeve dhe miratimit në Kryesinë e Degës, i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm.
4. Sekretari i Degës në ushtrimin e detyrës së tij ndihmohet nga Sekretarët Funksionale të Degës, të cilët zgjidhen nga Kryesia e Degës. Sekretarë Funksionale, mbulojnë fushat respektive sipas organizimit të Sekretarëve Funksional të PDSH-së. Detyrat që përmbush secili Sekretar Funksional dhe numri i tyre në çdo Degë caktohet me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm, sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara me vendim të Kryesisë së PDSH-së.

#### Neni 38

##### Bordi i Këshilltarëve

1. Pranë çdo Dege të PDSH-së ngrihet dhe funksionon Bordi i Këshilltarëve, në përbërje të të cilit zgjidhen individë me reputacion të lartë në Degë, personalitete të fushave të ndryshme të njohur për aktivitetin e tyre publik dhe promovimin e vlerave të qendrës së djathtë.
2. Bordi i Këshilltarëve është përgjegjës për hartimin e politikave dhe qëndrimeve sektoriale vendore, si dhe kontribuon me opinione dhe bashkëpunon në hartimin e platformave, strategjive dhe programeve sektoriale, të cilat përfshihen në programin elektorale, programin e qeverisjes dhe veprimtarinë politike të PDSH-së. Ai siguron koordinimin e veprimtarisë politike që ndërmerret Kryesia e Degës në fushat që mbulojnë dhe përgjigjet për punën e tij përpara Kryetarit dhe Kryesisë së Degës.
3. Anëtarët e Bordit të Këshilltarëve emërohen me vendim të Kryesisë së Degës. Fusha e veprimtarisë që mbulojnë anëtarët e Bordit të Këshilltarëve dhe numri i tyre në një Degë caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm, sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara me vendim të Kryesisë së PDSH-së.

#### Seksioni 3

##### Administrimi në organet vendore të partisë

#### Neni 39

##### Aparati Administrativ

Në përputhje me mundësitë e saj financiare dhe me miratim të Sekretarit të Përgjithshëm, Dege e PDSH-së ka aparatet e saj administrative, i cili funksionon sipas një rregulloreje të brendshme. Kryetari i Degës emëron dhe shkarkon personelin e kësaj administrate.

1. Financimi i strukturave vendore bëhet nga:

- shuma në formë granti që akordon Kryesia qendrore;
- kuotizacioni i anëtarësisë së territorit përkatës, të cilat shpërndahen sipas niveleve të ndryshme të organizimeve territoriale sipas kushteve të përcaktuara në aktet nënstatutore;
- kontributi që derdhen të zgjedhurit vendor e në qendër, shumë e cila përcaktohet nga Kryesia e Degës;
- burime të tjera financiare që autorizon ligji për partitë politike.

2. Kryetari i Bordit Financiar të Degës emërohet nga Kryesia e Degës. Ai është përgjegjës përpara Kryesisë për fondet që ka në administrim.

#### Neni 41

##### E drejta e informimit

Organet Qendrore të PDSH-së kanë të drejtë t'u kërkojnë organeve vendore çdo informacion lidhur me veprimtarinë e Degës së Partisë. Këtë të drejtë e kanë edhe organet drejtuese vendore ndaj strukturave nën varësi.

#### Neni 42

##### E drejta e ndërhyrjes

1. Në rast se Kryetari dhe/ose Kryesia e Degës thyejnë rëndë ose në mënyrë të përsëritur Statutin, dhe aktet e tjera të nxjerra nga organet qendrore në zbatim të tij, ose kur paralizohet veprimtaria normale e Degës, Kryesia e PDSH-së me propozim të Kryetarit të PDSH-së, ka të drejtën e ndërhyrjes dhe, në raste të veçanta, të shkarkimit, pezullimit të tyre, apo të komandimit të organeve drejtuese vendore respektive deri në mbledhjen e Kuvendit të Degës.

2. Kryesia e PDSH-së, me propozim të Kryetarit të PDSH-së, ka të drejtën e ndërhyrjes edhe në rastet e zbatimit të gabuar të akteve dhe procedurave në funksionimin e Degëve të Partisë.

3. Kryesia e PDSH-së, me propozim të Kryetarit të PDSH-së, ndërhyr në mënyrë të veçantë në rastet e konflikteve në procesin e propozimit të kandidaturave elektorale. Këto të drejta i ka edhe Kryesia e Degës ndaj seksioneve e grupseksioneve që ndodhen në territorin e saj.

## KREU V ORGANET QENDRORE TË PARTISË

### Seksioni I

#### Organet vendimmarrëse qendrore të PDSH-së

#### Neni 43

##### Kuvendi Kombëtar i Partisë

1. Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë, që përbëhet nga:

- Kryetarët e seksioneve të Partisë Demokratike dhe sekretarët e grupseksioneve të Partisë Demokratike;
- Anëtarët e Kryesive të degëve, përfshirë anëtarët e Bordit të Këshilltarëve të Degës;
- Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike;
- Anëtarët e Kryesisë së Partisë;
- Deputetët e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë;
- Kryetarët e Bashkive, Prefekti, Kryetari i Qarkut, dhe këshilltarët vendorë, anëtarë të PDSH-së;
- koordinatorët tematikë apo koordinatorët e procesit zgjedhor në Degët e Partisë Demokratike, si dhe funksionarët e Selisë Qendrore të Partisë Demokratike;
- Një numër i kufizuar përfaqësuesish të organizatave partnere në numër të barabartë jo më shumë se 5 për qind e numrit të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar.

2. Kuvendi Kombëtar mbledhet si rregull çdo katër vjet. Vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e PDSH-së, me propozim të Kryetarit të PDSH-së. Kuvendi mund të mbledhet edhe kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Data e zhvillimit të Kuvendit dhe rendi i ditës njoftohen të paktën një muaj përpara ditës së parë të Kuvendit. Punimet e Kuvendit drejtohen nga një Komision i përbërë nga 5 anëtarë, i cili zgjidhet në fillim të Punimeve të tij, me propozimin e Kryetarit të Partisë.

3. Kuvendi Kombëtar ka kompetencë për:

- miratimin e Statutit të PDSH dhe ndryshimin e tij;
- miratimin e programit të Partisë dhe linjave kryesore të politikës së saj, të cilat janë bazë pune për të zgjedhurit e PDSH-së në nivel qendror e vendor, si dhe për pushtetin ekzekutiv të drejtuar prej saj;
- zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar;
- shkarkimin e Kryetarit të Partisë mbi bazën e një mocioni mosbesimi të miratuar nga më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar;
- zgjedhjen e Kryetarëve të Nderit të PDSH, të cilët janë anëtarë me të drejtë vote në organet qendrore të PDSH-së për gjithë jetën;
- shpërndarjen e Partisë ose bashkimin me një ose disa parti të tjera;

4. Të drejtën për t'i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën gjasë Degë të PDSH-së.

#### Neni 44

##### Këshilli Kombëtar

1. Këshilli Kombëtar, në përputhje me programin, Statutin dhe vendimet e Kuvendit Kombëtar, drejton veprimtarinë politike të Partisë në periudhën midis dy Kuvendeve. Ai merr të gjitha vendimet e rëndësishme politike që mund të kërkojnë rishikim dhe kur ato nuk janë parashikuar në këtë Statut si e drejtë vetëm e Kuvendit.

2. Këshilli Kombëtar përbëhet nga anëtarë për shkak të funksionit dhe anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi Kombëtar. Janë anëtar të Këshillit Kombëtar për shkak të funksionit.

- a) anëtarët e Kryesisë së Partisë;
- b) anëtarët e Kolegjit të Kryetarëve;
- c) deputetët dhe ministrat në detyrë, anëtarë të PDSH-së;
- ç) kryetarët e Bashkive dhe Kryetarët e Këshillave të Bashkive dhe të Qarkut, që i përkasin Partisë Demokratike;
- d) ish-Presidentët, ish-Kryeministrat, ish-Kryetarët e Kuvendit dhe ish-Kryetarët e PDSH-së, që janë anëtarë të PDSH-së në momentin e mbledhjes së Këshillit Kombëtar;

3. Kuvendi Kombëtar zgjedh me votim të fshehtë jo më pak se 150 anëtarë të Këshillit Kombëtar, nga një listë e propozuar nga Kryetari i Partisë, ku numri i kandidatëve të mos jetë më pak se 1.5 herë më i madh se numri i vendeve që do të shpallen fitues dhe që njoftohet paraprakisht me vendim të Kryesisë së Partisë. Numri minimal i anëtarëve të zgjedhur nuk duhet të jetë më i vogël se numri i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për shkak të funksionit. Numri i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Kombëtar nga gjinia më pak e përfaqësuar të mos jetë më pak se 30%, ndërkohë që numri i të rinjve deri në moshën 35 vjeç të mos jetë më pak se 15%. Nëse kuotat e mësipërme nuk plotësohen nga renditja e dalë pas votimit, atëherë renditja e tyre veçohet nga ajo e përgjithshme.

4. Këshilli Kombëtar drejtohet nga Kryetari i Këshillit, i cili zgjidhet në mbledhjen e parë të konstituimit të Këshillit Kombëtar, mes të paktën dy kandidatëve alternativë.

5. Këshilli Kombëtar, si rregull, mbledhet jo më pak se një herë në vit. Data e mbledhjes dhe rendi i ditës duhet t'u njoftohen anëtarëve jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Mbledhjen e Këshillit Kombëtar e thërret Kryetari i Partisë ose Kryesia e Partisë. Këshilli Kombëtar mund të mbledhet edhe nëse e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të tij. Në këtë rast, Kryetari thërret mbledhjen jo më vonë se dy javë nga data e depozitimit të kërkesës.

6. Këshilli Kombëtar, ushtron këto përgjegjësi apo të drejta:

- a) vendos për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm; Nënkryetarëve të Partisë; Anëtarëve të zgjedhur të Kryesisë së PDSH-së; Sekretarëve funksionalë; Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të Apelit, Integritetit dhe Etikës; Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Zgjedhor, si dhe Kryetarit dhe anëtarëve të Bordit Financiar të Partisë;
- b) miraton anëtarët e emëruar nga Kryesia e PDSH-së në Komisionin e Vlerësimit të Kandidaturave dhe Komisionin Zgjedhor;
- c) miraton listën e kandidatëve elektorale sipas vendimit të Kryesisë së PDSH-së;
- ç) miraton strategjitë dhe programin elektorale e politik të PDSH-së;
- d) miraton koalicionet para apo pas zgjedhjeve;
- dh) shpall masat disiplinore për anëtarët e Këshillit Kombëtar apo Kryesisë së PDSH-së;
- e) miraton aktet më të rëndësishme nënstatutore për mbarëvajtjen e punës në Parti, sipas vlerësimit dhe propozimit të Kryesisë së PDSH apo Kryetarit të Partisë.

7. Të drejtën për t'i propozuar vendime Këshillit Kombëtar e kanë Kryetari i Partisë ose Kryesia e Partisë. Jo më pak se 15 për qind e anëtarëve të Këshillit Kombëtar kanë të drejtën që jo më vonë se 24 orë përpara mbledhjes së tij, të propozojnë kandidatë alternativë për çdo funksion politik që zgjidhet nga ky organ. Vendimet e Këshillit Kombëtar merren me shumicë të thjeshtë. Në rastin e masave disiplinore vendimet e Këshillit Kombëtar merren me 2/3 e votave. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar nuk mund të zhvillohen pa praninë e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve.

8. Anëtarët e zgjedhur të Këshillit Kombëtar organizohen në Departamente të Këshillit Kombëtar, që funksionojnë si struktura këshillimore e Kryesisë dhe Kryetarit të PDSH-së, për çështje tematike. Numri i departamenteve, fusha e veprimtarisë që mbulojnë, drejtuesit si dhe ndarja e anëtarëve në to, përcaktohen me vendim të Këshillit Kombëtar, me propozim të Kryetarit të Partisë. Departamentet e Këshillit Kombëtar janë përgjegjëse për përgatitjen e platformave, opinionëve, strategjive dhe programeve sektoriale, të cilat shërbejnë për formulimin e programit elektorale, programit të qeverisjes dhe veprimtarisë politike të PDSH-së. Departamentet sigurojnë koordinimin e veprimtarisë në fushat që mbulojnë ndërmjet partisë dhe grupit të saj parlamentar. Në mbledhjet e Departamenteve të Këshillit Kombëtar mund të marrin pjesë edhe anëtarët e Këshillit Kombëtar për shkak të funksionit. Departamentet përgjigjen për punën e tyre pranë Kryetarit të Këshillit dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Çdo vit ato hartojnë një raport për veprimtarinë vjetore, i cili i paraqitet për njohje Kryetarit të Partisë.

#### Neni 45

#### Kryesia e PDSH-së

1. Kryesia e PDSH-së ndjek dhe siguron zbatimin e vendimeve të marra nga Kuvendi dhe Këshilli Kombëtar. Kryesia vendos për të gjitha çështjet që nuk janë e drejtë ekskluzive sipas këtij statuti e Kuvendit Kombëtar dhe Këshillit Kombëtar, si dhe miraton marrëveshjet politike.

2. Kryesia e PDSH-së, drejtohet nga Kryetari i Partisë dhe ka në përbërje edhe:

- a) Sekretarin e Përgjithshëm;
- b) Nënkryetarët e Partisë;
- c) Sekretarët Funksionalë;
- ç) Kryetarin e Këshillit Kombëtar;
- d) Kryetarët e organizatave partnere;
- dh) Kryetarin e Bordit Financiar, Komisionit Zgjedhor dhe Komisionit të Apelit, Integritetit dhe Etikës;
- e) 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë të zgjedhur me votim të fshehtë nga Këshilli Kombëtar, nëpërmjet një numri kandidatësh të paktën sa dyfishi i numrit të vendeve vakante. Jo më pak se 30 % e anëtarëve të zgjedhur të Kryesisë duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar.
- ë) Zëdhënësi i Partisë, si dhe Sekretari për Marrëdhëniet Ndërkombëtare që emërohen nga Kryetari i PDSH-së.

3. Kryesia e Partisë ka këto përgjegjësi dhe të drejta:

- a) emëron Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Kandidatëve;
- b) emëron Sekretarin e Degës së PDSH-së;
- c) miraton kandidatët për Kryetar të Degëve të PDSH-së;
- ç) miraton kandidatët për kryetarë bashkie;
- d) cakton kandidatët për deputetë, pas konsultimit me anëtarësinë e PDSH sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Lista e kandidatëve për deputetë i paraqitet për miratim Këshillit Kombëtar;
- dh) ka të drejtë të vendosë për thirrjen e Kuvendit për zgjedhje të reja të Degës së Partisë dhe caktimin e organeve drejtuese të përkohshme të degës në përputhje me këtë Statut;
- e) miraton strukturën organike të PDSH-së dhe atë të pagave;
- ë) ka të drejtë t'i adresohet, secili prej anëtarëve të saj, edhe çdo kryesi degje, e organizatë partnere;
- f) ndërhyjnë dhe mund të refuzojë kandidatë të përzgjedhura nga organet vendore të Partisë.

4. Të drejtën për të kërkuar thirrjen e mbledhjes dhe për të propozuar vendime Kryesisë së Partisë e kanë Kryetari i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm ose 1/5 e anëtarëve të Kryesisë. Vendimet në Kryesi merren me shumicë të thjeshtë të votave në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të Kryesisë. Në rast se nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, atëherë mbledhja vijuese e saj për të njëjtin rend dite zhvillohet pavarësisht nga kuorumi.

1. Kryetari i Partisë kryeson organet qendrore të Partisë dhe siguron zbatimin e vendimeve të tyre. Ai përfaqëson Partinë në të gjitha veprimtaritë publike e politike, të brendshme dhe ndërkombëtare.
2. Kryetari i Partisë zgjidhet me votim të të gjithë anëtarëve të PDSH, sipas parimit "Një anëtar, Një votë". Modalitetet e procesit përcaktohen në aktet nënstatutore.
3. Kryetari i Partisë ndihmohet nga Nënkryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm. Kryetari i Partisë në varësi të problematikave apo çështjeve specifike mund të ngrejë struktura ndihmëse apo të caktojë koordinatore apo të deleguar, të cilat merren me shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre, apo drejtimin e procesit të ngarkuar.
4. Kryetari i Partisë gjatë veprimtarisë së tij të përditshme i cakton detyra dhe fusha të caktuara përgjegjësie Nënkryetarëve të Partisë. Në mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi, duke përfshirë rastet e dorëheqjes nga detyra të Kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar, i cili komandon Nënkryetarin që do të drejtojë Partinë deri në rikthimin e Kryetarit në detyrë apo zgjidhjen e Kryetarit të ri.
5. Kryetari i Partisë në përbushje të funksioneve të tij dhe garantimit të mbarevajtjes së punës në parti, nxjerr urdhra dhe udhëzime, në bazë dhe për zbatim të këtij Statuti, si dhe të vendimeve të organeve drejtuese të Partisë.

## Neni 47

## Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin e partisë, si dhe për funksionimin e përditshëm të saj. Ai organizon dhe ndjek zbatimin e akteve të nxjerra nga organet qendrore të partisë në degët e PDSH-së.
2. Sekretari i Përgjithshëm në ushtrimin e kompetencave të tij ndihmohet nga Sekretarët Funkcionalë, që emërohen nga Këshilli Kombëtar dhe mbulojnë fushat e veprimtarisë që përcaktohen me udhëzim të Kryetarit të PDSH-së.

## Seksioni 2

## Organet ndihmëse qendrore të PDSH-së

## Neni 48

## Grupi Parlamentar i Partisë

1. Grupi Parlamentar i PDSH-së përbëhet nga deputetët e saj në Kuvendin e Shqipërisë.
2. Grupi Parlamentar i PDSH-së:
  - a) përfaqëson në Parlament PDSH-në dhe siguron aty mbrojtjen e platformës, programit dhe interesave të PDSH-së;
  - b) harton programin dhe përcakton mënyrën e veprimit e të angazhimit të deputetëve të tij në Parlament dhe në zonat elektorale përkatëse;
  - c) vendos për ndarjen e anëtarëve të tij në komisionet parlamentare;
  - d) harton rregulloren e funksionimit të Grupit Parlamentar;
  - e) i propozon Këshillit Kombëtar për çështjet që janë kompetencë e këtij të fundit.

## Neni 49

## Kolegji i Kryetarëve

1. Kolegji i Kryetarëve, përbëhet nga të gjithë Kryetarët e Degëve të PDSH-së, dhe është strukturë ndihmëse dhe këshillimore e Kryetarit të Partisë.
2. Kolegji i Kryetarëve, ushtron këto përgjegjësi:
  - a) diskuton mënyrën e përbushjes së detyrave në kuadër të një aksioni apo aktiviteti politik, sipas vendimeve të marra nga organet drejtuese të PDSH-së;
  - b) këshillon Kryetarin e Partisë për ndërmarrjen e aksioneve politike dhe iniciativave që sigurojnë mbarevajtjen e punës në parti;
  - c) mbështet Kryetarin e Partisë në përbushjen e detyrave të caktuara nga organet drejtuese të partisë.

## Neni 50

## Komiteti i Orientimit të Politikave

1. Komiteti i Orientimit të Politikave përbëhet nga koordinatorët tematikë të shquar të fushave të ndryshme, të cilët emërohen nga Kryetari i Partisë. Ata janë përgjegjës për veprimtarinë dhe reflektime programore të PDSH-së në fusha të caktuara me rëndësi për veprimin publik politik të saj në shkallë vendi dhe më gjere.
2. Komiteti i Orientimit të Politikave ka për detyrë hartimin, propozimin dhe zbatimin e projekteve politike të PDSH-së për çështje specifike apo të përgjithshme tematike, të cilat miratohen nga organet drejtuese të saj. Kjo strukturë siguron marrjen e kontributit dhe mendimit të individëve apo organizatave me autoritet profesional, në fushën e ekspertizës që mbulojnë.

## Neni 51

## Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve

1. Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve, është strukturë ndihmëse dhe ka në përbërje 5 anëtarë. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Kandidatëve, me propozim të Kryetarit të PDSH-së, emërohen nga Kryesia e PDSH-së dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar.
2. Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve shqyrton kandidatuarat e propozuara nga strukturat lokale të Partisë dhe atyre të vetëpropozuara për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë.
3. Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve i raporton Kryetarit të Partisë dhe Kryesisë së PDSH-së mbi përbushjen nga kandidatët të kriterëve të parashikuara formale, atyre të pastërtisë së figurës, si dhe të elementëve të tjerë të nevojshëm për ecurinë në karrierë sipas këtij Statuti.
4. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët miratohen me akte nënstatutore dhe lidhen kryesisht, por pa u kufizuar, me arsimimin, integritetin, ligjshmërinë e pasurisë, të shkuarën gjatë regjimit komunist, mospasjen e rekordeve kriminale, si dhe standardet dhe rregullat që garantojnë integritetin dhe etikën.
5. Çdo kandidat është i detyruar që të plotësojë një vetëdeklarim mbi të dhënat e tij, si dhe të paraqesë çdo dokument të kërkuar nga Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve, që provon përbushjen e kriterëve dhe standardeve të përcaktuara.

#### Neni 52

#### **Ngritja e Qendrave dhe Instituteve të përhershme apo të përkohshme**

1. Pranë PDSH-së mund të ngrihen qendra apo institute të përhershme apo të përkohshme, si njësi kërkimore, këshilluese dhe trajnuese, të fokusuara në kërkimin dhe edukimin politik.
2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre, përcaktohen me udhëzim të Kryetarit të Partisë dhe në Statutin e organizatës përkatëse.

#### Seksioni 3

#### **Organet kontrolluese dhe garantuese qendrore të PDSH-së**

#### Neni 53

#### **Komisioni Zgjedhor**

1. Komisioni Zgjedhor është përgjegjës për organizimin dhe kontrollin e operacioneve elektorale brenda partisë dhe përbëhet nga shtatë anëtarë titullarë dhe dy ndihmës. Anëtarët e Komisionit Zgjedhor, me propozim të Kryetarit të PDSH-së, emërohen nga Kryesia e PDSH-së dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar.
2. Komisioni ka autoritetin për përgatitjen dhe organizimin e operacioneve të votimit në nivel kombëtar dhe lokal dhe siguron rregullsinë e tyre. Ai ndërhyr në zgjidhjen e çështjeve elektorale në deget e partisë në përputhje me aktet e rojçera për këtë qëllim. Ai përgjigjet përpara Kryesisë së Partisë.

#### Neni 54

#### **Komisioni i Apelit, Integritetit dhe Etikës**

1. Komisioni i Apelit, Integritetit dhe Etikës përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.
2. Komisioni shqyrton ankesat nga anëtarët e PDSH-së kundër masave disiplinore të marra ndaj tyre nga secili organ i partisë, si dhe kujdeset për respektimin e rregullave të bashkëjetesës në Parti dhe normat minimale të sjelljes së anëtarëve dhe respektit ndaj njëri-tjetrit, organeve të partisë dhe funksionarëve politike të partisë.
3. Gjate shqyrtimit të ankesave kundër masave disiplinore, Komisioni siguron të drejtën e anëtarit për një proces të rregullt ligjor. Vendimi i Komisionit është i paapelueshëm. Kur një Kryesi vendos të marrë një sanksion kundrejt një anëtari që mban një mandat zgjedhor, ekzekutiv ose parlamentar, ai nuk mund të bëhet publik veçse nëse vendos Kryesia e PDSH-së. Në të gjitha rastet e tjera, Komisioni deklaron vetë publikisht vendimet që merr.
4. Komisioni me kërkesë të Kryesisë së Partisë, shprehet për mospërfundim të vendimeve të marra nga organet qendrore, kryesitë apo anëtarët, me Statutin e Partisë, si dhe jep vlerësim mbi interpretimin përfundimtar të dispozitave të Statutit. Ai thërret për dëgjim, sipas rastit, të interesuarit.

### KREU VI

### **VEPRIMTARIA EKONOMIKE E PARTISË**

#### Neni 55

#### **Financat e Partisë**

1. Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njih ligji për partitë politike, si dhe nga çdo financim apo bunim tjetër që lejon ligji.
2. Masa e kuotës së anëtarësisë përcaktohet nga Kryesia e Partisë. Rregullat për mbledhjen, administrimin dhe përdorimin e kuotave të anëtarësisë përcaktohen në aktet nënstatutore.
3. Bilancet, ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe Buxheti Vjetor i Partisë, pasi raportohen pranë organeve kompetente sipas ligjit, bëhen publike në faqen zyrtare në internet të PDSH-së.

#### Neni 56

#### **Bordi Financiar i Partisë**

1. Bordi Financiar i Partisë përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.
2. Kryetari i Bordit është përgjegjës për administrimin e fondeve të Partisë. Ai i kërkon Kryesisë të shprehet për projektin e buxhetit dhe jep llogari para saj për zbatimin e këtij buxheti. Bordi Financiar, paraqet një opinion për projektin e buxhetit dhe propozon për miratim nga Kryesia e Partisë rregullat e përdorimit të fondeve të partisë.
3. Bordi kontrollon përdorimin rigoroz të financave të partisë. Në këtë funksion, ai mbledhet për të dhënë mendim para dorëzimit të bilancit të partisë në organet kompetente shtetërore dhe të partisë, si dhe para paraqitjes së buxhetit në Kryesinë e Partisë. Bordi mund të mbledhet edhe me kërkesën e më së gjysmës së anëtarëve për të rojçerë rekomandime për administrimin financiar të partisë. Këto rekomandime kanë fuqi zbatuese për Kryesinë e Partisë.

#### Neni 57

#### **Detyrimet pasurore**

1. Kryesia e PDSH-së nuk mund të marrë përsipër detyrime sipas të cilave anëtarët e saj përgjigjen me pasurinë personale.
2. Për detyrime tregtare ligjore të Partisë, anëtarët e organeve përkatëse përgjigjen vetëm me pasurinë e Partisë.
3. Organet e Partisë janë përgjegjëse për detyrimet e një organi më të ulët vetëm në rastin kur ato e kanë miratuar këtë detyrim.

### KREU VII

### **ORGANIZATAT PARTNERE**

#### Neni 58

#### **Organizatat partnere**

1. Partia ka këto organizata partnere:

a) Forumin Rinor të Partisë Demokratike (FRPD);

b) Lidhjen Demokratike të Gruas (LDG);

2. PDSH-ja mbështet veprimtarinë politike të organizatave partnere në gjithë territorin e vendit. Organizatat partnere synojnë që të promovojnë idetë dhe programet e PDSH në grupet shoqërore ku ato veprojnë, si edhe të paraqesin e mbrojnë interesat e këtyre grupeve në politikën e PDSH-së.

3. PDSH-ja garanton përfaqësimin e organizatave partnere në të gjitha nivelet e përfaqësimit politik, ku përfaqësimi i LDG është në standardin minimum të parashikuar nga ligji elektoral, ndërkohë që përfaqësimi i FRPD është me standardin minimal 10 për qind të të zgjedhurve në Këshillat Vendiore, si dhe me 5 për qind të listës së kandidatëve për në Kuvendin e Shqipërisë.

4. Parimet bazë të strukturës së tyre organizative janë të ngjashme me ato të PDSH. Miratimi i statutit të organizatave partnere dhe ndjekja në vijimësi e zbatimit të tij bëhet nga Kryesia e Partisë.

## **KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 59**

#### **Aktet nënstatutore**

Për zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë statut, organet vendimmarrëse të Partisë, miratojnë akte nënstatutore si si rregullore, udhëzime, vendime, dhe urdhra, të cilat janë të detyrueshme për zbatim. Vendimmarrjet e Kuvendit Kombëtar dhe Këshillit Kombëtar mund të pasqyrohen në Procesverbalin e mbledhjeve të këtyre organeve, i cili mbahet sipas rregullave dhe nga personat e caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

### **Neni 60**

#### **Rishikimi i statutit**

Ky Statut mund të rishikohet nga Kuvendi i Partisë me shumicën e të gjithë të anëtarëve të tij sipas propozimeve të Kryesisë së Partisë, së një të katërtes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Për përgatitjen e ndryshimeve në Statut ngrihet dhe funksion Komisioni i Përhershëm i Statutit, i cili është përgjegjës edhe për interpretimin e dispozitave të Statutit. Komisioni i Përhershëm i Statutit përbëhet nga 7 anëtarë titullarë dhe dy anëtarë ndihmës, dhe caktohet nga Kryesia e Partisë.

### **Neni 61**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë ditën e miratimit të tij nga Kuvendi Kombëtar.

Miratuar në Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2021